


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Maj, 2019

Tiranë, më 10 Qershor 2019: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Maj 2019, arriti 106,5 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Maj 2019 është 1,5 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 2,1 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Maj 2019, krahasuar me Prill 2019, është - 1,0 %.


Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit. Rritja vjetore e çmimeve në muajin Maj është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,17 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,24 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,05 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “Argëtim dhe kulturë” dhe “Transporti” kanë kontribuar me -0,02 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Shëndeti” kanë kontribuar me -0,01 pikë përqindje.

Për publikim 10/06/2019

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Maj 2018, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3,1 %, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,4 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 1,1 % secili, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Shërbimi arsimor” me 0,7 %, secili, “Veshje dhe këpucë” me 0,5 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” u ulën me 0,6 %, pasuar nga grupet “Shëndeti” dhe “Transporti” respektivisht me 0,5% dhe 0,1 %. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 10,5 %, pasuar nga nëngrupet “fruta” me 7,7 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 3,1 %, “peshk” me 0,9 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “vajra dhe yndyrna” u ulën me 1,1 %.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Prill 2019, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u ulën me 2,6 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0,6 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,2 %, etj. Ndërsa, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” u rritën me 0,7 %, pasuar nga grupi “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,1 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	05-18	06-18	07-18	08-18	09-18	10-18	11-18	12-18	01-19	02-19	03-19	04-19	05-19
	Gjithsej	100	104,9	104,9	104,6	105,0	105,2	105,0	104,8	105,9	107,6	108,2	107,9	107,6	106,5
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	37,0	109,2	108,8	108,2	109,1	109,5	108,4	107,8	110,6	115,7	117,3	116,4	115,5	112,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,5	103,3	103,4	103,4	103,4	103,3	103,4	103,7	104,4	104,7	104,6	104,7	104,6	104,8
3	Veshje dhe këpucë	3,6	98,5	99,0	98,5	98,4	98,9	99,6	99,8	99,9	100,2	100,1	99,5	99,6	99,0
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	21,5	104,1	104,3	104,2	104,3	104,4	105,0	105,1	105,3	105,3	105,3	105,1	105,3	105,3
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	5,6	99,9	99,7	99,2	99,3	99,5	99,6	99,7	100,2	100,1	100,5	100,7	100,7	100,5
6	Shëndeti	3,2	100,4	99,9	99,6	99,6	99,6	99,6	99,4	99,8	99,7	99,8	99,9	100,0	99,9
7	Transporti	6,9	101,8	102,4	103,0	103,3	103,5	104,3	103,8	102,6	101,2	101,2	101,7	101,8	101,6
8	Komunikimi	2,8	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1	101,2	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,2
9	Argëtim dhe kulturë	2,7	105,8	105,8	105,2	105,7	107,8	106,7	104,9	105,0	104,3	104,9	105,0	104,4	105,2
10	Shërbimi arsimor	3,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,4	102,0	102,1	102,1	102,1	102,1	102,1	102,1	102,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,1	101,0	101,0	101,2	101,2	101,1	101,2	101,2	101,8	101,8	101,9	102,0	102,1	102,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,7	103,7	103,7	103,6	103,6	103,6	103,5	103,5	103,6	103,8	103,7	103,8	103,8	103,6

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	05-18/05-17	06-18/06-17	07-18/07-17	08-18/08-17	09-18/09-18	10-18/10-17	11-18/11-17	12-18/12-17	01-19/01-18	02-19/02-18	03-19/03-18	04-19/04-18	05-19/05-18
	Gjithsej	2,1	2,4	2,3	2,2	2,1	1,9	1,8	1,8	1,9	1,7	1,1	1,4	1,5
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,8	3,2	3,0	2,8	2,6	1,8	2,0	2,8	4,3	3,8	2,0	2,7	3,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,6	1,6	1,7	1,8	1,7	1,8	1,9	2,5	1,8	1,6	1,0	1,0	1,4
3	Veshje dhe këpucë	2,2	3,3	2,3	2,4	0,6	-0,3	-0,4	-1,6	-0,8	-0,3	0,0	0,3	0,5
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	2,7	2,9	2,8	2,8	2,8	3,4	3,1	2,2	0,8	0,9	1,0	1,2	1,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,0	-0,1	-0,3	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,2	0,5	0,7	0,7
6	Shëndeti	0,2	-0,2	-0,5	-0,4	-0,4	-0,4	-1,0	-0,5	-0,6	-0,5	-0,4	-0,3	-0,5
7	Transporti	2,1	3,1	3,2	3,0	3,2	4,3	2,5	1,4	0,0	0,1	0,5	0,4	-0,1
8	Komunikimi	0,6	0,6	0,6	0,6	0,7	0,7	0,6	0,5	0,4	0,1	0,0	0,2	0,2
9	Argëtim dhe kulturë	3,5	4,2	4,6	5,3	5,2	3,2	3,0	2,7	1,8	2,1	1,1	-1,1	-0,6
10	Shërbimi arsimor	0,6	0,6	0,6	0,6	0,5	0,8	0,8	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,9	0,9	1,1	1,1	1,0	1,0	1,0	1,2	1,1	1,1	1,2	1,1	1,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,3	0,3	0,2	0,2	0,1	0,1	0,1	0,1	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	05-18	06-18	07-18	08-18	09-18	10-18	11-18	12-18	01-19	02-19	03-18	04-19	05-19
	Gjithsej	-1,2	-0,1	-0,3	0,4	0,2	-0,2	-0,2	1,1	1,6	0,6	-0,3	-0,2	-1,0
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	-3,0	-0,3	-0,5	0,8	0,3	-1,0	-0,6	2,6	4,6	1,4	-0,8	-0,7	-2,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	-0,3	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,3	0,7	0,3	-0,1	0,1	0,0	0,1
3	Veshje dhe këpucë	-0,8	0,5	-0,5	-0,2	0,6	0,7	0,2	0,1	0,2	-0,1	-0,6	0,0	-0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,6	0,1	0,1	0,0	0,0	-0,2	0,2	-0,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,1	-0,1	-0,6	0,2	0,1	0,2	0,0	0,5	-0,1	0,4	0,2	0,0	-0,1
6	Shëndeti	0,1	-0,5	-0,3	0,0	0,0	0,0	-0,2	0,4	0,0	0,0	0,1	0,1	-0,1
7	Transporti	0,4	0,6	0,5	0,3	0,2	0,8	-0,5	-1,2	-1,4	0,0	0,5	0,0	-0,1
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,2	0,0	-0,5	0,4	2,0	-1,0	-1,7	0,1	-0,6	0,6	0,1	-0,6	0,7
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,6	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,1	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,6	0,0	0,1	0,1	0,1	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,2	0,0	-0,1	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	-0,2

SHPJEGIME METODOLOGJIKE

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2017,
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime,
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet,

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare, Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve,

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm, Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj,

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale,

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm,